



Planuar / Dorezuar Prunijeno/Prodato Received/Delivered	07 - 06 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSICK	4677	/2023	1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.717/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Avdyll Bekteshi-Zyrta i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.717/2023 të datës 08.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ permes përfaqësuesi me autorizim avokat _____ me adresë _____ kundër Vendimit me Nr. Reference 01-116-49838 të datës 06.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "ndërrprerje nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Refuzohet si pa bazuar* ankesa me numër A.nr.717/2023 e datës 08.05.2023 e parashtruar nga ankuesi _____
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me Nr. Reference 01-116-49838 i datës 06.04.2023 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Prizrenit.

A r s y e t i m

Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit "Prim.Dr. Daut Mustafa", më datë 25.08.2022 ka shpallur konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës në kohë të caktuar për pozitën Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve të Përbashkëta. Tutje sipas Vendimit me Nr. Amz.1455 të datës 07.11.2022 të lëshuar nga Drejtoresha Ekzekutive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren, ankuesi pranohet në marrëdhënia punë në pozitën e lartcekur, ndërsa më datë 07.11.2022 ka nënshkruar edhe kontratës me numër të kontratës 1455 për këtë pozitë.

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prizrenit në pozitën Auditor i Brendshëm sipas Akt Emërimit të datës 22.10.2014, më datë 07.11.2022 ka parashtruar tek Kryetari i Komunës së Prizrenit kërkesë për pezullimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Kryetari i Komunës së Prizrenit më datë 06.12.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 01-060/01-0171338/22 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, përmes postës më datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 11.01.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.43/2023 me numër protokoll 169/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 09.02.2023 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.43/2023 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me Nr. 01-060/01-0171338/22 e datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit.

Pas pranimit të Vendimit të Këshillit nga Komuna e Prizrenit, më datë 19.02.2023 Udhëheqësi i Njësisë së Personelit ka njoftuar Udhëheqësin e Njësisë së Auditimit në Komunën e Prizrenit për këtë vendim, ndërsa Udhëheqësi i Njësisë së Auditimit në Komunën e Prizrenit përmes emailit të datës 09.03.2023 ka njoftuar Kryetarin e Komunës së Prizrenit duke e mbajtur CC (njoftuar) edhe ankuesin se nga data 19.02.2023 deri sot ankuesi nuk është paraqitur në vendin e punës.

Më datë 16.03.2023 është bërë iniciimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor me arsyetimin për shkelje të rënda disiplinore konkretisht braktisje e punës ose mungesë e paarsyeshme për pesë ditë apo më shumë dhe atë nga data 19.02.2023 deri në iniciim.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prizrenit pas seancës së mbajtur më datë 06.04.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. References 01-116-49838 përmes të cilit ankuesit i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Ankuesi kundër këtij vendimi, përmes postës më datë 05.05.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 08.05.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.717/2023 me numër protokoll 4134/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prizrenit. Ndërsa Këshilli më datë 26.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4134/2023 e datës 08.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për pezullim të marrëdhënies së punë e parashtruar më datë 07.11.2022 nga ankuesi për Kryetarin e Komunës dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore; Emailin e datës 07.12.2023 nga ankuesi; Emailin e datës 29.03.2023 nga ankuesin; Vendimin me Nr. References 01-116-49838 i datës 06.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit; Vendimin me Nr. amz.1455 të datës 07.11.2022 të Drejtoreshës Ekzekutive në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren; Dokument identifikimi për ankuesin; Zarin e datës 05.05.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.05.2023; Akt Emërimit të datës 22.10.2014; Kontratë Pune për kohë të caktuar me Nr. 1455 datës 07.11.2022; Vendimin me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit; Emailin e datës 19.02.2023 nga ankuesi për kryetarin; Emailin e datës 15.02.2023 nga ankuesin; Vendimin A.nr.43/2023 i datës 09.02.2023 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 27.03.2023, 21.03.2023 nga ankuesi për kryetarin; Emailin e datës 09.03.2023 nga ankuesin për kryetarin; Vendimin me Nr. 01-020-81571 të datës 03.06.2022 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr. 01-116/01-0042042/23 i datës 21.03.2023 anëtar rezervë të Komisionit Disiplinor; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 16.03.2023; Emailin e datës 30.03.2023 nga ankuesi për kryetarin; Emailin e datës 31.03.2023 nga ankuesin; Gjendja e hyrje/daljeve në punë prej datës 04.11.2022 deri më datë 22.06.2023 për ankuesin; Procesverbal i datës 03.04.2023 i Komisionit Disiplinor; Autorizimin e datës 19.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Referencës 01-116-49838 të datës 06.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit, pretendon se vendimi është nxjerr me shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Zyrtarët Publikë, sepse nuk janë përshkruar emrat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor në preambulë të vendimit, po ashtu dispozitivi i vendimi është i paqartë dhe i pakuptueshëm për faktin që se i njëjti bie ndesh me nenin 44, 46, 47, 48, 125 e lidhur me nenin 127 alineja 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes vendimit A.nr.43/2023 të datës 09.02.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit të datës 11.01.2023 ndërsa ka lënë në fuqi Vendimin me Nr. 01-060/01-0171338/22 të datës 06.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, duke konstatuar se sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pezullim të marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Në bazë të provave të lëndës pala ankuese vendimin e cekur më lartë të Këshillit të Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka pranuar më datë 15.02.2023 ndërsa Komuna e Prizrenit këtë vendim e ka pranuar më datë 14.02.2023.

Kolegji i Këshillit, përkitazi me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ndaj Vendimit me Nr. Referencës 01-116-49838 të datës 06.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me këtë ankesë përmban elementet e aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase në pjesën hyrës (preambulë) të vendimit është shkruar emri i organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, si rrjedhojë sipas kësaj dispozitë nuk është specifikisht e përcaktuar që duhet të përshkruhen emrat e organit që ka nxjerr aktin në këtë rast emrat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, kështu që ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se ky vendim bie ndesh me nenin 125 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, konstaton se në kuadër të elementeve të aktit administrativ Vendimi me Nr. Referencës 01-116-49838 i datës 06.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit ka udhëzuar palën e pakënaqur që ndaj këtij akti mund të parashtrij ankesë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në këtë kuptim ankuesit nuk i janë cenuar asnjë e drejtë për përdorimin e mjeteve juridike për kundërshtim të këtij vendimi, ngase ku vendim në këtë pjesë është në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se Vendimi me Nr. Referencës 01-116-49838 i datës 06.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit është nxjerr me shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Zyrtarët Publikë ngase vendimi është i paqartë dhe i pakuptueshëm, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të kësaj procedure, konstaton se inicimi i procedurës disiplinore nga Menaxheri i Personelit ndaj ankuesit është bërë me arsyetimin se i njëjti nga data 19.02.2023 (kur Komuna e Prizrenit ka pranuar Vendimin A.nr.43/2023 të Këshillit) deri në kohën e inicimit të procedurës disiplinore nuk është paraqitur në punë, është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi konkretisht me nenin 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Duke marr për bazë që vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është vendim administrativ i formës së prerë sipas nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nëse ankuesi ka hapur konflikt administrativ ndaj Vendimit A.nr.43/2023 të Këshillit, atëherë i njëjti në momentin që ka pranuar vendimin e Këshillit ka qenë i obliguar që të paraqitet në vendin e punës ngase sipas paragrafit 2 të nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcaktohet se: *"Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit"*, ndërsa nga provat e administruara konstatohet se ankuesi edhe përkundër faktit që ka pranuar Vendimin me numër A.nr.43/2023 të Këshillit

në kohën e lartcekur i njëjti nuk është paraqitur në vendin e punës të cilën e ka të përcaktuar me Akt emërimit.

Lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë, respektivisht Vendimit me Nr. Referencës 01-116-49838 të datës 06.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prizrenit, dhe shqyrtimit të të gjitha pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Neni 45 ka përcaktuar se: "*... Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".*

Neni 46 ka përcaktuar se: *1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".*

Neni 47 ka përcaktuar se: "*1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".*

Meqenëse ankuesi nuk është paraqitur në vendin e tij të punës pas pranimit të Vendimit me numër A.nr.43/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës duke munguar në punë për pesë (5) ditë e më tepër, kështu që ankuesi me veprimet për mosparaqitje në vendin e tij të punës ka vepruar në kundërshtim me nenit 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "*zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij",* po ashtu ankuesi më veprimet e tij ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-114



për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Shkelje të rënda konsiderohen: braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë"*, nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, si rrjedhojë Komisioni Disiplinor i Komunës së Prizrenit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Referencës 01-116-49838 të datës 06.04.2023, ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat e administruara, duke vepruar edhe në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësimit disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, kështu që rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase arsyetimin e vendimit e ka bërë sipas gjendjes faktike, dhe në këtë kuptim, Kolegji, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit, janë të pabazuara.

Theksuar i më lart, e duke bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.717/2023.

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokat
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.